

V E N D I M
Nr.496, datë 18.10.1993

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.328 DATË
30.6.1993 "PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE"**

Në zbatim të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror", me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.328, datë 30.6.1993, pas pikës 3 shtohet pika 1/a me këtë përmbajtje:

"Për përfitimin e ndihmës ekonomike nuk merret parasysh ndarja e familjes, me përjashtim të rasteve kur brenda saj krijohet kurorë e re".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 30.6.1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi